



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*  
*Ministria e Financave*  
*Ministarstvo za Finansije - Ministry of Finance*

---

**RAPORTI VJETOR 2017 I PROGRESIT TË IMPLEMENTIMIT TË STRATEGJISË  
SË REFORMËS SË MENAXHIMIT TË FINANCAVE PUBLIKE 2016-2018**

Prishtinë  
Prill 2018

<b>1.- PËRMBLEDHJA EKZEKUTIVE</b>	<b>4</b>
<b>2.- PROGRESI I PËRGJITHSHËM I ZBATIMIT TË STRATEGJISË</b>	<b>6</b>
<b>3.- INFORMIM I PËRGJITHSHËM MBI PROGRESIN E STRATEGJISË SIPAS FUSHAVE PRIORITARE, INDIKATORËVE DHE AKTIVITETEVE</b>	<b>9</b>
<i>3.1.- Progresi i përgjithshëm i zbatimit të reformave në shtyllën 1: Disiplina fiskale</i>	<b>12</b>
3.1.1.- Prioriteti 1: Saktësia e parashikimit të indikatorëve makroekonomik dhe të hyrave	12
3.1.2.- Prioriteti 2: Kontrollat efektive të zotimeve	13
3.1.3.- Prioriteti 3: Mbledhja e qëndrueshme e të hyrave	14
<i>3.2.- Progresi i përgjithshëm i zbatimit të reformave në shtyllën 2: Efektiviteti Alokues</i>	<b>15</b>
3.2.1.- Prioriteti 4: Zhvillimi i kornizës afatmesme të shpenzimeve (KASH)	15
3.2.2.- Prioriteti 5: Besueshmëria dhe kontrolli i ekzekutimit të buxhetit vjetor	16
3.2.3.- Prioriteti 6: Cilësia e informatave të buxhetit kapital	17
<i>3.3.- Progresi i përgjithshëm i zbatimit të reformave në shtyllën 3: Efikasiteti operacional</i>	<b>17</b>
3.3.1.- Prioriteti 7: Prokurimi Publik	18
3.3.2.- Prioriteti 8: Fuqizimi i auditimit të brendshëm	19
3.3.3.- Prioriteti 9: Fuqizimi i auditimit të jashtëm	19
<i>3.4.- Progresi i përgjithshëm i zbatimit të reformave në shtyllën 4: Çështjet e lidhura me MFP</i>	<b>21</b>
3.4.1.- Prioritet 10: Përmirësimi i sistemeve të TI	21
3.4.2.- Prioriteti 11: Transparenca për buxhetin	21
3.4.3.- Prioriteti 12: Ngritja e qëndrueshme e kapaciteteve në MFP	22
<b>4.- VEPRIMET PRIORITARE PËR VITIN E ARDHSHËM</b>	<b>23</b>
4.1.- Prioriteti 1: Saktësia e parashikimit të indikatorëve makroekonomik dhe të hyrave.	23
4.2.- Prioriteti 2: Kontrollat efektive të zotimeve	23
4.3.- Prioriteti 3: Mbledhja e qëndrueshme e të hyrave	23
4.4.- Prioriteti 4: Zhvillimi i kornizës afatmesme të shpenzimeve (KASH)	24
4.5.- Prioriteti 5: Besueshmëria dhe kontrolli i ekzekutimit të buxhetit vjetor	24
4.6.- Prioriteti 6: Cilësia e informatave të buxhetit kapital	24
4.7.- Prioriteti 7: Prokurimi Publik	24
4.8.- Prioriteti 8: Fuqizimi i auditimit të brendshëm	25
4.9.- Prioriteti 9: Fuqizimi i auditimit të jashtëm	25
4.10.- Prioritet 10: Përmirësimi i sistemeve të TI	25
4.11.- Prioriteti 11: Transparenca për buxhetin	26
4.12.- Prioriteti 12: Ngritja e qëndrueshme e kapaciteteve në MFP	26

## Shkurtesat

AB - Auditimi i Brendshëm  
ATK - Administrata Tatimore e Kosovës  
BE - Bashkimi Evropian  
BDMS (Budget Development and Management System) - Sistemi i Zhvillimit dhe Menaxhimit të Buxhetit  
COSO (Committee of Sponsoring Organizations of the Treadway Commission) - Komiteti i Sponsorimit të Organizatave të Komisionit Treadway  
DK - Dogana e Kosovës  
DMR - Divizioni i Menaxhimit të Rrezikut  
FMN - Fondi Monetar Ndërkombëtare  
GDPS - Grupi Drejtues për Planifikim Strategjik  
IPSAS (International Public Sector Accounting Standards) - Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik  
KBF - Komisioni për Buxhet dhe Financa  
KASH - Korniza Afatmesme e Shpenzimeve  
KE - Komisioni Evropian  
KIP - Komiteti për Investime Publike  
KBFP - Kontrolli i Brendshëm i Financave Publike  
KMFP - Kontrolli i Brendshëm i Financave Publike  
KRPP - Komisioni Rregullativ i Prokurimit publik  
LPP - Ligji për Prokurimin Publik  
LMFPP - Ligji për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë  
MF - Ministria e Financave  
MFP - Menaxhimi i Financave Publike  
MSA - Marrëveshja e Stabilizim Asociimit  
OB - Organizatat Buxhetore  
PEFA (Public Expenditure and Financial Accountability) - Llogaridhënia Financiare dhe e Shpenzimeve Publike  
PIFC (Public Internal Financial Control) - Kontrolli i Brendshëm i Financave Publike  
PIP - Programi i Investimeve Publike  
PVF - Pasqyra Vjetore Financiare  
PPF – Project Preparation Facility  
SBS (Sector Budget Support) - Përkrahja Buxhetore Sektoriale  
SIGMA (Support for Improvement in Governance and - Përkrahje për Përmirësim në Qeverisje dhe Menaxhment Management)  
SIMFK - Sistemi Informativ i Menaxhimit të Financave të Kosovës  
SRMFP - Strategjia për Reformën e MFP  
TI - Teknologjia Informative  
ZAP - Zyra e Auditorit të Përgjithshëm  
ZPS - Zyra për Planifikim Strategjik  
ZKM - Zyra e Kryeministrit

**Shënim:** Ky dokument është hartuar nga Grupi për Koordinim të Implementimit të Strategjisë së Reformës së Financave Publike në Republikën e Kosovës dhe shërben për të raportuar në Nën-Këshillin e RAP dhe në Ministrinë e Financave. Me qenë se nuk është prezantuar (e as miratuar) ende në këtë forum, Ky dokument është draft dhe nuk mund të përdoret pa autorizim me shkrim nga Ministria e Financave.

## 1.- Përmbledhja ekzekutive

Ky raport i përmbledh dhe paraqet arritjet e objektivave dhe progresin në aktivitete të Strategjisë së Reformës së Menaxhimit të Financave Publike (SRMFP) gjatë vitit 2017 dhe veprimet e ardhshme për 2018.

Grupi Koordinues për Menaxhimin e Financave Publike (GKMFP) sipas mandatit të dhënë me Vendimin e Ministrit, Nr. 43/2016, obligohet të përgatis raporte të rregullta vjetore të vlerësimit të progresit dhe t'i paraqesë ato në formën e raportit vjetor të monitorimit të zbatimit të Strategjisë së Reformës së Menaxhimit të Financave Publike (SRMFP). Zbatimi i SRMFP, ndërton në planin e veprimit të SRMFP dhe Pasaportën e Indikatorëve. Bazuar në të dhënat e raportuara nga institucionet përgjegjëse, sipas strategjisë dhe planit të veprimit dhe duke marrë në referencë indikatorët e performancës, raportohet se ka një progres në shumicën nga fushat e zbatimit të strategjisë. Megjithatë, grupi dëshiron të sjell në vëmendje të vendim marrësve se qasje më sistematike dhe më shumë fonde janë të nevojshme për zbatimin e plotë të strategjisë. Qasja e adoptuar në përgatitjen e raportit vjetor është vazhdimësi e vitit 2016 e cila ka qenë një kombinim i takimeve dhe punëtorive punuese. Fillimisht është përgatitur tabela raportuese dhe është dërguar tek institucionet përgjegjëse. Pasi janë dhënë kontributet e para është organizuar një punëtori, ku janë diskutuar dhe inkorporuar kontributet e strukturave përgjegjëse. Grupi, përgjatë vitit 2018 do të angazhohet për udhëzime më të qarta për prezantim më tabelar në raportimin vjetor dhe atë 6 mujor.

Strategjia e Reformës së Menaxhimit të Financave Publike (SRMFP), është ndërtuar mbi 4 shtylla dhe 12 prioritetet që përfshijnë të gjithat fushat e reformës së Menaxhimit të Financave Publike.

### Shtylla I: Disiplina Fiskale

Për vitin 2017 mund të raportohet për trend përmirësimi në shtyllën e **Disiplinës Fiskale** kundrejt çaqeve të dhëna në strategji. Tek Prioriteti i parë është ruajtur dhe përmirësuar saktësia e parashikimit të Indikatorëve makroekonomik dhe të të hyrave. Shmangia mesatare e parashikimit të të hyrave të rregullta në krahasim me të hyrat e realizuara është -1.10%, që siguron trendin pozitiv drejt vlerës së synuar për vitin 2018 dhe cakun në 2020. Përmirësim ka edhe në Prioritetin e tretë, në të tre indikatorët e ATK-së. Numri i bizneseve të regjistruara për TVSH, Numri i tatimpaguesve që i deklarojnë të ardhurat në mënyrë vullnetare dhe Shkalla e mbledhjes së borxheve janë në kufijtë e çaqeve të dhëna me planin e veprimit.

Për sa i përket kontrolleve efektive të zotimeve, të matura me treguesin e strategjisë, është ruajtur rezultat i mirë por treguesi është mbi caqet e vëna. Borxhet e pakryera të pagesave deri në fund të vitit fiskal si % e totalit të shpenzimeve për vitin 2017 janë 4.2 %. Ky tregues është më i dobët se në vitin 2016. Me qëllim të tejkalimit të kësaj sfide, Qeveria ka ndërmarr disa hapa duke plotësuar dhe harmonizuar legjislacionin primar dhe sekondar lidhur me procesin e buxhetimit, prokurimit dhe shpenzimit të parasë publike. Krijimi i obligimeve pa pasur mjete buxhetore nga OB-të përbën shkelje ligjore. Prandaj OB-të obligohen që të raportojnë vonesat në pagesa, ndërsa MF do raportojë obligimet e papaguara nga OB-të në Raportin Vjetor Financiar.

### Shtylla II: Efikasiteti Alokues

Në fushën e **Efikasitetit Alokues**, e matur me caqet e vëna në SRMFP, ka progres të mirë. Tek Prioriteti i katërt kanë vazhduar veprimet për zhvillimin e kornizës afatmesme të shpenzimeve (KASH) përmes avancimit të mëtejshëm të rolit të KASH si dokument ndërlidhës ndërmjet Strategjive Kombëtare dhe planifikimit të buxhetit. Megjithatë, ndryshimet në orientimet strategjike për shkak të ndryshimeve politike janë reflektuar në numrat buxhetor dhe në KASH. Është rritur shmangia në mes të kufirit të shpenzimeve në KASH dhe Buxhetit të aprovuar në

Kuvend për vitin 2017. Shmangia në shumë prej EUR 180 milion është shpërndarë nëpër OB. Kjo ka rezultuar që përqindja e shmangies mesatare ndërmjet kufirit të KASH dhe kufirit vjetor buxhetor për OB-të të jetë 22% krahasuar me vitin bazë kur ishte 7.5%.

Tek Prioriteti i pestë, besueshmëria dhe kontrolli i ekzekutimit të buxhetit vjetor e ka ruajtur përgjithësisht trendin e kufijve të pranueshëm. Është regjistruar zvogëlimi i vazhdueshëm i numrit të transfereve gjatë vitit fiskal. Në anën tjetër, kemi shmangie në ekzekutim të përgjithshëm të buxhetit, krahasuar me buxhetin e aprovuar për 11.42 %, që është më shumë se në vitin 2016 dhe vitin bazë kur ishte 10.46%.

Prioriteti i gjashtë ngjashëm me dy të mëparshmit shënon progres për sa i përket Numrit të ri-alokimeve për OB-të e nivelit qendror. Në vitin 2017 numri i ri-alokimeve ishte vetëm 33 krahasuar me 65 sa ishte numri i vitit bazë, dhe ka arritur me lartë se vlera e synuar për vitin 2018. Përqindja e zbatimit të buxhetit të investimeve kapitale krahasuar me buxhetin e planifikuar brenda një viti fiskal, si tregues i strategjisë, nuk ka progres. Por vlen të theksohet se e gjitha kjo mund t'i atribuohet mjeteve të AKP-së të paraqitura në Buxhetin e Aprovuar dhe klauzola e investimeve të buxhetuara me ligjin vjetor të buxhetit. Lidhur me këtë, është formuar një grup punues për hartimin e Rregullores/Instruksionit nga Qeveria për ta fuqizuar departamentin e buxhetit që ofron një kornizë të qartë për politik-bërësit dhe përdoruesit e PIP-it në lidhje me metodologjinë e vlerësimit dhe përzgjedhjen e projekteve.

### **Shtylla III. Efikasiteti operacional**

Në vitin 2017, në fushën e **Efikasitetit Operacional** trendi i arritjeve sipas planit të reformës është i dukshëm pothuajse në të gjithë indikatorët e performancës.

Në Prokurimin Publik, Prioriteti i shtatë, është arritur progres në realizimin e parimit “vlera për para” përmes zvogëlimit në 9,17% të përdorimit të procedurës së negociuar pa publikim si dhe përmes arritjes 70% të monitorimit të njoftimeve për kontratë, të publikuara nga KRPP.

Fuqizimi i auditimit të brendshëm ka vazhduar edhe këtë vit me ngritjen e kapaciteteve. Është arritur fuqizimi i mëtejshëm i auditimit të brendshëm përmes rritjes së numrit të auditorëve të brendshëm të certifikuar në 85%. Megjithatë, në fushën e auditimit të brendshëm përqindja e implementimit të rekomandimeve nga menaxhmenti nuk ka trend përmirësimi dhe është sfidë që do të adresohet me rishikimin e strategjisë në gjysmën e dytë të vitit 2018.

Zhvillimi i një institucioni suprem të auditimit që funksionon mirë, i cili kryen auditime në përputhje me standardet e auditimit të sektorit publik të pranuar ndërkombëtarisht është drejtim i duhur. Veprime konkrete që kanë të bëjnë me sistemet, njerëzit dhe standardet janë ndërmarr gjatë vitit 2017. Megjithatë, tek Prioriteti i nëntë përqindja e rekomandimeve të adresuara të lëshuara nga Zyra Kombëtare e Auditimit edhe pse në kufij të mirë 26%, mbetet për tu përmirësuar. Duhet thënë se këto të dhëna kanë të bëjnë me rekomandimet e vitit 2015, e të zbatuara në vitin 2016.

### **Shtylla IV. Çështjet e ndërlidhura me MFP**

Në shtyllën e katërt, ka pas zhvillime në zbatimin e Prioritetit të dhjetë lidhur me përmirësimin e sistemeve të TI-së. Disa nga aktivitetet janë zbatuar apo kanë filluar zbatimin sipas planit, e disa kanë vonesë.

Tek Prioriteti i njëmbëdhjetë, Thesari ka zhvilluar një mori aktivitetesh në funksion të përmirësimit të sistemit të teknologjisë informative dhe proceseve që ndërlidhen me procesin buxhetor. SIMFK ka komunikuar/ndërlidhur në mënyrë elektronike me sisteme të treta si: Sistemi i Pagesave Ndër-Bankare në BQK, BDMS, PIP, ZKA, ATK, Doganë, DOJQ, KEDS. Janë gjeneruar raporte elektronike me të gjitha sistemet e treta si dhe është arritur progres në transparencën buxhetore, duke bërë publikimin e të dhënave mujore serike. Po ashtu është raportuar për avancim në raportim sipas standardeve SFQ (GFS)–FMNS, që përfshinë harmonizimin e planit kontabël aktual me standardet e GFS.

Tek Prioriteti që adreson ngritjen e kapaciteteve në fushën e MFP në mënyrë sistematike, të qëndrueshme dhe të integruar, është raportuar për hartim të Termave të Referencës për studimin e fizibilitetit. Ka ngecje në zbatim, si sfidë kryesore e ngecjes në zbatimin e studimit të fizibilitetit është mungesa e mjeteve financiare. Janë bërë përpjekje për sigurimin e mjeteve fillimisht në Buxhet, e pastaj edhe tek donatorët por pa sukses. Përfundimi i Studimit është parakusht për zbatimin e aktiviteteve të këtij prioriteti.

## 2.- Progresi i përgjithshëm i zbatimit të Strategjisë

Për periudhën raportuese 2017, progres ka në shumicën e dimensioneve të katër shtyllave të strategjisë së SRMFP. Megjithatë, Raporti gjen që ka disa fusha të caktuara që kërkojnë më shumë vëmendje. Për më shumë, gjatë rishikimit afatmesëm, disa veprime ose edhe orientime strategjike duhet rishikuar pasi kanë ndërruar orientimet strategjike.

Në shtyllën e parë, **Disiplina Fiskale**, progres ka në 4 indikator, 1 indikator ka progres të pjesshëm dhe në 1 indikator nuk mund të raportojmë progres.

Shmangia mesatare e parashikimit të të hyrave tatimore në krahasim me aktualet ka progres. Ky tregues është -1.1 % për vitin 2017. Si kurse në vitin 2016, më pak progres ka në indikatorin e të hyrave të njëhershme (-16.5%)<sup>1</sup>

Borxhet e pakryera të pagesave janë administruar mirë, por deri në fund të vitit fiskal 2017, treguesi si % e totalit të shpenzimeve, është 4.2%, pothuajse dy pikë të % më lartë se caku i ndërmjetëm dhe më dobët se viti paraprak (2016: 3.5 %). Tashmë Qeveria e Republikës së Kosovës (QRK) ka ndërmarrë disa hapa të veprimit duke plotësuar dhe harmonizuar legjislacionin primar dhe sekondar.

Të tre treguesit që kanë të bëjnë me performancën e ATK-së kanë progres. Numri i bizneseve të regjistruara për TVSH është 21,708. Krahasuar me vitin bazë 2015 (16,583) por edhe me cakun e ndërmjetëm 2018 (21,750) ky tregues është në trend të mirë. Numri i tatimpaguesve që i deklarojnë të ardhurat në mënyrë vullnetare është 66,767. Treguesi që mat shkallën e mbledhjes së borxheve është 25 % dhe e ka tejkaluar edhe cakun 2020 (18%).

Në shtyllën e dytë, **Efikasiteti Alokues**, indikatorin e shmangies mesatare ndërmjet kufirit të KASH dhe kufirit vjetor buxhetor për OB-të ka rënie. Në vitin 2016 vlera ishte 3.52% (respektivisht 7.66%) e përafërt krahasuar me vitin 2015 (7.15 %) ky tregues është 22.03 % në 2017. Grupi është njoftuar me shkaqet (EUR 180 milion më shumë Buxhet i Aprovuar) dhe është duke rishikuar mënyrën e reflektimit në SRMFP, duhet parë edhe caku për 2020 i cili duket të jetë tepër ambicioz (3.5%). Ngritja e kapaciteteve përmes trajnimit për vlerësimin e ndikimit buxhetor ka vazhduar kënaqshëm bazuar në nevojat (mbi 90 zyrtar).

Progres ka edhe në indikatorin që mat numrin e ri-alokimeve për OB të nivelit qendror. Përqindja e shmangies mesatare të ekzekutimit të përgjithshëm të buxhetit krahasuar me buxhetin e aprovuar sipas OB të nivelit qendror është 11.42 % dhe nuk është arritur krahasuar me vitin referues<sup>2</sup>. Numri i transfereve brenda vitit 2017 (149) ka rënë krahasuar me vitin 2015 (199) dhe vitin 2016 (188).

Në vitin 2017, përqindja e zbatimit të buxhetit të investimeve kapitale krahasuar me buxhetin e planifikuar brenda një viti fiskal nuk është arritur. Ky mos realizim i shpenzimeve kapitale

<sup>1</sup> Të hyrat e njëhershme për vitin 2017 janë planifikuar të jene 13 milion €, gjatë vitit 2017 janë mbledhur 10.9 13 milion €.

<sup>2</sup> Ky tregues nuk është brenda planifikimit të arritjes afatmesme për vitin 2020 (5%), për arsye se me proces të rishikimit të buxhetit janë ulur shpenzimet nga AKP (87 mil.) si dhe klauzola e investimeve (nga 105 mil. sipas buxhetit të aprovuar në 2 mil. me buxhetin e rishikuar).

është si pasojë e mjeteve të AKP-së dhe klauzola e investimeve të buxhetuara me Ligjin Vjetor të Buxhetit<sup>3</sup>.

Në shtyllën 3 të strategjisë, **Efikasiteti Operacional**, progres ka në indikatorët e performancës së prokurimit publik ku përqindja e përdorimit të Procedurës së Negociuar pa publikim ka rënë në 9.17% kurse përqindja e monitorimit të njoftimeve për kontratë ka arritur në 70% që është nën vlerën e synuar.

Progres të pjesshëm ka në fuqizimin e kontrollit të brendshëm dhe në indikatorin e lidhur me performancën e ZKA-së. Si në auditimin e brendshëm (48.59%) ashtu edhe në atë të jashtëm (26%), % e rekomandimeve të adresuara është nën plan të arritjeve. Vlen të theksohet se progres ka shënuar përqindja e auditorëve të brendshëm të certifikuar në 85%.

Në shtyllën e 4 të strategjisë, **në çështjet horizontale të MFP**, ka progres të pjesshëm. Janë ndërmarrë veprime në drejtim të rritjes së pajtueshmërisë së informatave për buxhetin e Kosovës me standardin e FMN. Publikimi i serive kohore të të hyrave dhe shpenzimeve të përgjithshme të Qeverisë në vitin 2017 është publikuar në ueb faqen e Ministrisë së Financave. Integrimi i sistemeve të TI në MF dhe agjencitë e saja vartëse ka shënuar përparim. Departamenti i TI-së në bashkëpunim të ngushtë me Komitetin Teknik të TI-së (KTTI) kanë arritur të avancojnë infrastrukturën e TI-së dhe rritjes së TI-së, si parakusht për integrimin e sistemeve të TI-së. Janë hartuar termat e referencës për integrimin e sistemeve të TI-së dhe është shpallur oferta për përzgjedhjen e operatorit ekonomik. Janë mbyllur ofertat dhe komisioni teknik është në fazën e përzgjedhjes së operatorit ekonomik.

Për sa i përket treguesve të fundit për Ngritjen e qëndrueshme të kapaciteteve në MFP dhe Numrit të zyrtarëve të trajnuar në fushën e MFP, gjatë vitit 2017 nuk ka të dhëna pasi ende nuk është implementuar studimi i fizibilitetit, përfshirë vlerësimin e nevojave. Mungesa e mjeteve financiare është adresuar në disa nivele, dhe aktualisht pritet përgjigja e fondit SAFE ku është adresuar projekt propozimi.

SRMFP me rastin e hartimit ka kaluar fazën e kostimit me ç'rast janë identifikuar zbrazëirat financiare të aktiviteteve të planifikuara në strategji. Gjatë hartimit të buxhetit për vitin 2018, është bërë përpjekje për adresim të këtyre zbrazëtirave me buxhet shtesë për strukturat implementuese të strategjisë. Vlen të përmendet se janë ndarë mjete buxhetore shtesë që ndërlidhen me Prioritetet e disa institucioneve përgjegjëse për zbatimin e SRMFP-së.

<b>Institucioni</b>	<b>Fusha e përkrahjes për vitin 2018 me buxhet shtesë</b>	<b>Shuma në Euro</b>
KRPP	Mirëmbajtja e platformës së e-prokurimit	152,000
Zyra Kombëtare e Auditimit (rritja e numrit të punëtorëve për 7)	pagat, mallrat, kapitalet dhe shpenzime komunale	393,000
MF/ Thesari	Mallra dhe Kapitale	285,000
MF/ ATK	Mallra dhe Kapitale (projekti “Sistemi i ri bazë i tatimeve”)	1,850,000
MF/ Dogana e Kosovës	Mallra	549,683
Total - Buxheti shtesë për vitin 2018		3,329,683

Gjatë tërë vitit GKMFP është angazhuar së bashku me përfaqësuesit e Zyrës së BE-së në Prishtinë në adresimin e kërkesave që dalin në procesin e hartimit të Kontratës së Reformave Sektoriale (Sector Reform Contract – SRC). Fillimisht është punuar në Dokumentin Aksional (Action Document), për të kaluar në Draftin iniciues të Kontratës Financiare, që përmban pjesën përshkruese si dhe pjesën lidhur me Indikatorët relevant për transhet e SBS. Së bashku

<sup>3</sup> AKP ka pasur me Buxhet të Aprovuar (BA) € 87 mil., ndërsa me rishikim janë zbritur këto mjete, ndërsa Klauzola e investimeve me BA ka pasur 105 mil. ndërsa me Buxhet të Rishikuar është ulur kjo masë monetare në 2 mil

me Zyrën e BE-së, dhe të përkrahur nga SIGMA dhe projekti PPF, është kaluar nëpër fazat si më poshtë :

1. Rishikimi kualitativ I (Quality review I): shkurt 2017
2. Komiteti FAST I (FAST Committee I): 31 mars 2017
3. Rishikimi kualitativ II (Quality review II): 5 maj 2017
4. Komiteti FAST II (FAST committee II): 24 maj 2017
5. Konsultimet nder-sektoriale (Interservice consultation)

Më 21 Shtator 2017, Komiteti i IPA në takimin e mbajtur në Bruksel ka aprovuar Përkrahjen Buxhetore Sektoriale (SBS) për fushën e MFP në vlerë prej 21 milion euro SBS dhe 4 milion euro Asistence Teknike. Prej këtu e deri në Dhjetor 2017, është punuar në identifikimin dhe dakordimin e Indikatorëve Variabil.

Jemi falënderues për përkrahjen e projekteve të ndryshme nga :

- FMN, në kërkesat e MF për nevoja specifike për fusha të caktuara si Tatimet, Thesari, etj.
- USAID, si përkrahja në zbatimin e marrëveshjes Stand by Agreement me FMN, veçanërisht në implementimin e rregullës fiskale, në azhurnimin e planit kontabël, në publikimin e serive kohore si dhe ndihmë për Departamentin Makro në përmirësimin e rregullës fiskale.
- BE, përmes projektit SIGMA dhe PPF, mbështetje e vazhdueshme me ekspertizë dhe organizim të punëtorive për GKMFP.
- GIZ, në fushën e tatimeve, mbështetje Departamentit të Buxhetit dhe Kuvendit të Kosovës në fushën e MFP, si dhe projekti i GIZ International përmes përkrahjes GKMFP me ekspertizë dhe shkëmbim të përvojave në rajon.

Gjithashtu GKMFP ka adresuar nevojën për përkrahje, sidomos të Prioritetit 12 të SRMFP. Së fundmi është hartuar projekt propozimi për mbështetje të Fondit SAFE. Mbështetja ka të bëjë kryesisht me Vlerësimin e nevojave për trajnim si dhe të Studimit të Fizibilitetit për modelin më të mirë të ngritjes së kapaciteteve në fushën e MFP.

Duhet cekur se zbatimi i SRMFP-së është ngushtë i lidhur me mbështetjen buxhetore Sektoriale tashmë të aprovuar nga Komiteti i IPA. Padyshim se Qeveria është e përkushtuar në zbatimin e strategjisë, por është evidente pamundësia e mbulimit të zbrazëtirës financiare tashmë të kostuar. GKMFP gjatë rishikimit të SRMFP, në pjesën e dytë të vitit 2018, ka paraparë edhe Kostimin e Planit të rishikuar të Veprimit.

Prioritetet e SRMFP janë të reflektuar edhe në dokumentet relevante strategjike të vendit si SKZH, PRE, ERA, PKZMSA etj. Kështu për shembull Prokurimi Publik është Masa e parë e Fushës së MFP në PRE 2018. Është po ashtu si prioritet në Shtyllën e dytë të ERA, në fushën e përmirësimit të mjedisit afarist, përmes masës së Zbatimit të prokurimit elektronik në prokurimet e centralizuara. Kështu janë edhe çështjet tjera si Stabiliteti makroekonomik, KASH, Buxhetimi, Raportimi financiar, Auditimi i Brendshëm dhe i Jashtëm etj.

Strategjia aktuale e Kontrollit të brendshëm të Financave Publike (KBFP) 2015-2019 si dhe Strategjia e Prokurimit Publik 2017-2021, zbatohen dhe monitorohen rregullisht nga strukturat përgjegjëse relevante.



### 3.- Informim i përgjithshëm mbi progresin e strategjisë sipas fushave prioritare, indikatorëve dhe aktiviteteve

Në terma të përgjithshëm, Grupi Koordinues i Strategjisë së Reformës për Menaxhimin e Financave Publike (Grupi Koordinues) për vitin 2017 mund të raportojë për progres në shumë nga fushat e reformës.

Në të gjitha objektivat e caktuara, në fushat prioritare të intervenimit, janë ndërmarrë veprime konkrete sipas planit të veprimit për vitin 2017.

Strategjia e Reformës së Menaxhimit të Financave Publike (SRMFP), është ndërtuar mbi 4 shtylla dhe 12 prioritete që përfshijnë të gjithat fushat e reformës së Menaxhimit të Financave Publike. Në vijim është tabela me vlerat relevante të treguesve për të katër shtyllat e SRMFP-së:



Progres krahasuar me arritjen referuese

E njëjtë apo afërsisht e krahasueshme me arritjen referuese

Nën arritjen referuese

Shtylla 1:	Disiplina Fiskale					
Objektivi 1	Indikatori (-ët) për matjen e arritjes së objektivit	Baza	Vlera e synuar 2018	Qëllimi 2020	Raportimi 2016	Raportimi 2017
Një parashikimi i kujdesshëm dhe real i të hyrave të rregullta të buxhetit dhe të hyrave të njëhershme.	1. Shmangia mesatare e parashikimit të të hyrave në krahasim me ekzistueset.	(-7.7%)	5%	0 – 3 %	3.82%	-1.10%
	2. Shmangia mesatare e parashikimit të të hyrave që ndodhin në buxhet vetëm një herë në krahasim me ekzistueset.	(-7.6%)	5%	4%	13.33%	-16.50%
Objektivi 2	Indikatori (-ët) për matjen e arritjes së objektivit	Baza	Vlera e synuar 2018	Qëllimi 2020	Raportimi 2016	Raportimi 2017
Zvogëlimi i vonesave të pagesave duke e rritur pajtueshmërinë me kontrollet e aplikueshme të zotimeve.	1. Borxhet e pakryera të pagesave deri në fund të vitit fiskal si % e totalit të shpenzimeve.	3%	2%	1%	3.50%	4.20%
Objektivi 3	Indikatori (-ët) për matjen e arritjes së objektivit	Baza	Vlera e synuar 2018	Qëllimi 2020	Raportimi 2016	Raportimi 2017
Zgjerimi i bazës tatimore përmes luftimit të evazionit fiskal dhe kontrabandimit të mallrave.	1. Numri i bizneseve të regjistruara për TVSH	16,583	21,75	35,000	24,653	20,708
	1. Numri i tatimpaguesve që i deklarojnë të ardhurat në mënyrë vullnetare.	62,886	73,117	100,000	62,347	66,767
	2. Shkalla e mbledhjes së borxheve.	16%	18%	19%		25%
Shtylla 2	Efikasiteti alokues					
Objektivi 4	Indikatori (-ët) për matjen e arritjes së objektivit	Baza	Vlera e synuar 2018	Qëllimi 2020	Raportimi 2016	Raportimi 2017
Avancimi i mëtejshëm i rolit të KASH si dokument ndërlidhës ndërmjet Strategjive	1. Përqindja e shmangies mesatare ndërmjet kufirit të KASH dhe kufirit vjetor buxhetor për OB-të.	7.15%	6.50%	3.50%	3.52% (7.66%)*	22.03%

Kombëtare dhe planifikimit të buxhetit për tre vitet e ardhshme..	2.Numri i zyrtarëve të trajnuar për vlerësimin e ndikimit buxhetor-VNB.	80	90	120	40+40	90
* Kjo sepse dy OB nuk kanë qenë të planifikuara me KASH (2016-2018) ndërsa janë pjesë e ligjit për ndarje buxhetore për vitin 2016 (RTK dhe Agjensioni për Shërbimet e Navigimit Ajror). Pa këto dy OB % e shmangies është 3.52						
<b>Objektivi 5</b>	<b>Indikatori (-ët) për matjen e arritjes së objektivit</b>	<b>Baza</b>	<b>Vlera e synuar 2018</b>	<b>Qëllimi 2020</b>	<b>Raportimi 2016</b>	<b>Raportimi 2017</b>
Fuqizimi i besueshmërisë së buxhetit vjetor përmes përmirësimit të planifikimit buxhetor dhe besueshmërisë së tij, përfshirë planifikimin në nivel të programeve, për të siguruar që hartimi i buxhetit është në përputhje me kornizën makro-fiskale si dhe objektivat strategjike të Qeverisë.	1.Përqindja e shmangies mesatare të ekzekutimit të përgjithshëm të buxhetit krahasuar me buxhetin e aprovuar në fillim të vitit sipas OB të nivelit qendror.	10.46%	9.00%	5%	3.86%	11.42%
	2.Nr. i transfereve gjatë vitit fiskal	199	170	100	188	149
<b>Objektivi 6</b>	<b>Indikatori (-ët) për matjen e arritjes së objektivit</b>	<b>Baza</b>	<b>Vlera e synuar 2018</b>	<b>Qëllimi 2020</b>	<b>Raportimi 2016</b>	<b>Raportimi 2017</b>
Një menaxhim më efikas dhe më efektiv i planifikimit dhe monitorimit të investimeve publike nga OB-të në sistemin e PIP-it do të ndikoj në një planifikim të drejtë të projekteve kapitale që duhet të jenë të ndërlidhura me Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe me prioritetet e Qeverisë.	1.Numri i ri-alokimeve për OB të nivelit qendror.	65	55	25	56	33
	2.Përqindja e zbatimit të buxhetit të investimeve kapitale krahasuar me buxhetin e planifikuara brenda një viti fiskal	98%	170	100%	86%	59%
<b>Shtylla 3:</b>	<b>Efikasiteti operacional</b>					
<b>Objektivi 7</b>	<b>Indikatori (-ët) për matjen e arritjes së objektivit</b>	<b>Baza</b>	<b>Vlera e synuar 2018</b>	<b>Qëllimi 2020</b>	<b>Raportimi 2016</b>	<b>Raportimi 2017</b>
Sigurimi i përdorimit efikas, transparent dhe të drejtë të fondeve publike si dhe realizimi i parimit kryesor në prokurimin publik “vlera për para”.	1.Përqindja e përdorimit të Procedurës së Negociuar pa publikim.	12,98 %	10%	7%	11.76%	9.17%.
	2.Përqindja e monitorimit të njoftimeve për kontratë.	5%	100%	100%	80%	70%
<b>Objektivi 8</b>	<b>Indikatori (-ët) për matjen e arritjes së objektivit</b>	<b>Baza</b>	<b>Vlera e synuar 2018</b>	<b>Qëllimi 2020</b>	<b>Raportimi 2016</b>	<b>Raportimi 2017</b>

Fuqizimi i funksionit të auditimit të brendshëm si shërbim me vlerë të shtuar ndaj menaxhimit llogaridhënës	1.Përqindja e auditorëve të brendshëm të certifikuar	50%	80%	90%	65.33%	85.00%
	2.Përqindja e implementimit të rekomandimeve nga menaxhmenti.	51%	65%	65%	54.70%	48.59%
<b>Objektivi 9</b>	<b>Indikatori (-ët) për matjen e arritjes së objektivit</b>	<b>Baza</b>	<b>Vlera e synuar 2018</b>	<b>Qëllimi 2020</b>	<b>Raportimi 2016</b>	<b>Raportimi 2017</b>
Zhvillimi i një institucioni suprem të auditimit që funksionon mirë, i cili kryen auditime në përputhje me standardet e auditimit të sektorit publik të pranuar ndërkombëtarisht.	1. Përqindja e raporteve të auditimit të shqyrtuara nga Komisioni për Mbikëqyrje të Financave Publike.	10%	30%	50%	14.14%	12.5%
	2.Përqindja e rekomandimeve të adresuara të lëshuara nga Zyra Kombëtare e Auditimit	32%	45%	60%		26%
	3.Përqindja e rekomandimeve të pa adresuara të lëshuara nga Zyra Kombëtare e Auditimit	37%	25%	20%		38%
<b>Shtylla 4:</b>	<b>Çështjet e ndërlidhura të MFP</b>					
<b>Objektivi 10</b>	<b>Indikatori (-ët) për matjen e arritjes së objektivit</b>	<b>Baza</b>	<b>Vlera e synuar 2018</b>	<b>Qëllimi 2020</b>	<b>Raportimi 2016</b>	<b>Raportimi 2017</b>
Përmirësimi i sistemeve të TI që funksionojnë në Ministrinë e Financave për ta përmirësuar cilësinë e informatave financiare.	1.Numri i sistemeve të Integruara	0	5	7	0	Duke u bërë përzgjedhja e OE për Integrim të sistemeve
<b>Objektivi 11</b>	<b>Indikatori (-ët) për matjen e arritjes së objektivit</b>	<b>Baza</b>	<b>Vlera e synuar 2018</b>	<b>Qëllimi 2020</b>	<b>Raportimi 2016</b>	<b>Raportimi 2017</b>
Sigurimi i pajtueshmërisë së informatave për buxhetin e Kosovës me FMN standardin GFS 2014.	1.Buxhetimi dhe raportimi sipas tabelës së llogaritjeve që është në pajtim me GFS 2014	Ka filluar publikimi	Planifikimi i Buxhetor sipas GFS 2014	Standardi GFS 2014 në përdorim	Përgatitjet në vijim	Pritet rishikimi i Rregullës financiare per Planin Kontabël te harmonizuar me GFSM dhe IPSAS.
<b>Objektivi 12</b>	<b>Indikatori (-ët) për matjen e arritjes së objektivit</b>	<b>Baza</b>	<b>Vlera e synuar 2018</b>	<b>Qëllimi 2020</b>	<b>Raportimi 2016</b>	<b>Raportimi 2017</b>
Arritja e një mënyrë sistematike, e qëndrueshme dhe e integruar e ngritjes së kapaciteteve të nëpunësve civilë në Menaxhimin e Financave Publike duke e shfrytëzuar ekspertizën vendore, të administratës publike dhe atë të jashtme.	1.Ngritja e qëndrueshme e kapaciteteve në MFP				Përgatitjet në vijim	Ngritja e kapaciteteve si më parë
	2. Numri i zyrtarëve të trajnuar në fushën e MFP				Përgatitjet në vijim	Ngritja e kapaciteteve si më parë

Në vijim Grupi Koordinues i prezanton gjetjet nga monitorimi i zbatimit të SRMFP për vitin 2017 sipas Prioriteteve dhe Aktiviteteve.

### 3.1.- Progresi i përgjithshëm i zbatimit të reformave në shtyllën 1: Disiplina fiskale

Në shtyllën e parë të SRMFP Disiplina Fiskale, janë 3 Prioritete. Në këtë seksion po e prezantojmë progresin në drejtim të arritjes së objektivit dhe aktiviteteve të ndërlidhura për çdo prioritet në këtë shtyllë për vitin 2017.

#### 3.1.1.- Prioriteti 1: Saktësia e parashikimit të indikatorëve makroekonomik dhe të hyrave

Parashikimi i besueshëm dhe real i të hyrave tatimore është një nga fushat prioritare të reformës. Në indikatorin e parë, shmangia mesatare e parashikimit të të hyrave të rregullta në krahasim me të hyrat tatimore të realizuara sipas raportit vjetor financiar të buxhetit për vitin 2017, është - 1.1%. Ky indikator është poshtë kufirit të vënë për vitin 2020. Për më shumë, nëse e krahasojmë me vitin 2016, është më e ultë dhe ndikon për trend të qëndrueshëm.

Në pjesën e të hyrave të njëhershme tatimore, indikatorin ka shmangie në -16.15%. Ky tregues është dallueshmërisht më shumë se sa baza dhe synimi për 2020. Përkundër vlerës së vogël në buxhet, grupi është duke analizuar cilësisht indikatorin për të parë saktë çfarë mund të bëhet. Për më shumë ky indikator është më shumë (si pikë e përqindjes) se sa viti 2016 dhe si duket ka të bëjë më shumë me planifikimin se sa me kapacitetin e realizimit.

Për krahasim në vitin 2016, ishin të parapara të inkasohen EUR 18 milion. ndërsa realizimi për vitin 2016 ishte EUR 20.4 milion.<sup>4</sup>

Objektivi	Indikatorët për matjen e arritjes së objektivit	Baza	Vlera e synuar 2018	Qëllimi 2020	Raportimi 2016	Raportimi 2017
Një parashikimi i kujdesshëm dhe real i të hyrave të rregullta të buxhetit dhe të hyrave të njëhershme.	1. Shmangia mesatare e parashikimit të të hyrave në krahasim me ekzistueset.	(-7.7%)	5%	0 – 3 %	3.82 %	-1.1 %
	2. Shmangia mesatare e parashikimit të të hyrave që ndodhin në buxhet vetëm një herë në krahasim me ekzistueset.	(-7.6%)	5%	4 %	13.33 %	-16.5 %

#### Komenti për statusin e aktiviteteve 1.1- 1.5

Në arritjen e këtij objektivit, janë paraparë 5 grup-aktivitete. Në grup-aktivitetet 1.1 (Të siguruarit e kapacitetit të mjaftueshëm të stafit të trajnuar të njësisë makroekonomike) vlerësimi kundrejt arritjeve në vitin 2017 tregon që ka progres. Në grup aktivitet 1.2-1.4, përkundër përpjekjeve dhe iniciativave, ka më pak progres të dokumentuar. Më saktësisht:

- (1.1) Gjatë vitit 2017 kanë vazhduar trajnimet për stafin në veçanti modelimin e indikatorëve makroekonomik dhe projeksionin e të hyrave.
- (1.2) Sa i takon këtij aktivitetit, në 2016 është hartuar një draft i metodologjisë. I njëjti nuk është publikuar ende.
- (1.3) Edhe gjatë vitit 2017 korniza makro-fiskale dhe indikatorët ekonomik janë publikuar si pjesë të Kornizës Afatmesme të Shpenzimeve. Publikimi i kornizës makro-fiskale dhe indikatorëve ekonomikë para miratimit të KASH dhe Ligjit Vjetor të Buxhetit mbetet një veprim që duhet të trajtohet përmes një grupi punues në pjesën e dytë të 2018.

<sup>4</sup>Të dhënat e përdorura bazohen në raportin vjetor financiar të aprovuar me datë 22 mars 2017.

- (1.4) Me vendim të Qeverisë së Kosovës të datës 08.12.2016 është bërë ristrukturimi i Departamentit. Divizioni i Politikave Makroekonomike është ndarë nga Divizioni i Politikave fiskale. Megjithatë, Ministria e Financave është duke analizuar opsionet institucionale që garantojnë qëndrueshmërinë e pavarësisë së Njesisë Makroekonomike.
- (1.5) Ende nuk është themeluar Grupi punues për kufizim të përfshirjes së të hyrave të njëhershme në Ligjin Vjetor të Buxhetit. Duke pas parasysh që pjesa më e madhe e të hyrave të njëhershme vjen nga Ligji për faljen e borxheve, dhe duke pas parasysh që ligji është në fuqi deri më 31 gusht 2017, grupi koordinues i SRMFP ka rekomanduar nevojën e krijimit të grupit punues.

### 3.1.2.- Prioriteti 2: Kontrollat efektive të zotimeve

Kontrollet efektive të zotimeve janë një nga hallkat kryesore të ndërlidhjes së planifikimit dhe ekzekutimit të resurseve publike. Strategjia në këtë prioritet, mbështetet në veprime për ndryshime ligjore, sisteme-organizative dhe ndërtim të resurseve njerëzore.

Në këtë drejtim, përkundër që borxhet e pakryera të pagesave deri në fund të vitit fiskal si % e totalit të shpenzimeve janë më shumë se viti bazë (3.4%) mund të raportojmë që ky tregues është në nivel të pranueshëm (4.2%).

Grupi është duke analizuar trendet edhe me Departamentin Përgjegjës për të reflektuar në rishikimin e strategjisë.

Objektivi	Indikatori-ët për matjen e arritjes së objektivit	Baza	Vlera e synuar 2018	Qëllimi 2020	Raportimi 2016	Raportimi 2017
Zvogëlimi i vonesave të pagesave duke e rritur pajtueshmërinë me kontrollet e aplikueshme të zotimeve.	1. Borxhet e pakryera të pagesave deri në fund të vitit fiskal si % e totalit të shpenzimeve.	3.4% <sup>5</sup>	2 %	1 %	3.5 %	4.2 %

#### Komenti për statusin e arritjeve në aktivitetet 2.1-2.9

Për arritjen e këtij qëllimi, strategjia ka grupuar 9 aktivitete. Arritjes sipas aktiviteteve janë:

- (2.1) Gjatë vitit 2017 nuk është aprovuar në Kuvend Ligji për KBFP.
- (2.2) NJQH/MFK ka trajnuar 108 zyrtar financiar për menaxhimin e rrezikut. Thesari ka trajnuar stafin e OB-ve për përdorim të SIMFK sipas përgjegjësisë të përcaktuar në përshkrimin e vendit të punës.
- (2.3) Kontabiliteti i kesh është veprim i planifikuar për 2018.
- (2.4) Libri për përshkrimin e proceseve është aprovuar nga Ministri i Financave. Është bërë prezantimi i përshkrimit të proceseve para të gjithë zyrtarëve financiar të OB-ve.
- (2.5) Arritja e dhënë për 2017 nuk është plotësuar në tërësi. Gjatë vitit 2017 janë testuar disa mundësi që të përfshihet edhe bashkëngjitja e dokumentacionit financiar të skanuar secilit transaksion të regjistruar në SIMFK.
- (2.6) Rishikimi i rregullores financiare për raportimin e vonesave në pagesa nuk është bërë.
- (2.7) Raportimi i borxheve të brendshme nga Njësia e borxheve sipas arritjes për 2017 nuk është bërë.

<sup>5</sup>Vlera bazë i referohet vitit 2015, % =  $54,619,395.00 / 1,597,983.00 = 3.4\%$

- (2.8) Analiza e raportimit të vonesave në pagesa nga OB-të dhe njoftimi për Ministrin për të vazhduar me ndëshkimet për OB-të të cilat kanë shkaktuar vonesa në pagesa në mënyrë sistematike nuk është bërë.
- (2.9) Monitorimin e OB-ve përmes SIMFK-së dhe arkivës elektronike nuk është bërë.
- (2.10) Nuk ka të dhëna për ngritjen e kapaciteteve tek Njësia për Monitorim (NJpM).

### 3.1.3.- Prioriteti 3: Mbledhja e qëndrueshme e të hyrave

Mbledhja e qëndrueshme e të hyrave është një nga prioritetet kryesore në drejtim të integritetit të përgjithshëm të menaxhimit të financave publike.

Në vitin 2017, është ruajtur trendi i performancës së agjencive tatim-mbledhëse për të siguruar qëndrueshmëri të mbledhjes së të hyrave përmes zgjerimit të bazës tatimore, masave kundër evazionit fiskal dhe kontrabandës. Numri i bizneseve të regjistruara për TVSH ka tejkaluar cakun e vënë për vitin 2018.

Objektivi	Indikatori (-ët) për matjen e arritjes së objektivit	Baza	Vlera e synuar 2018	Qëllimi 2020	Raportimi 2016	Raportimi 2017
Zgjerimi i bazës tatimore përmes luftimit të evazionit fiskal dhe kontrabandimit të mallrave.	1. Numri i bizneseve të regjistruara për TVSH	16,583	21,75	35,000	24,653	20,708
	2. Numri i tatimpaguesve që i deklarojnë të ardhurat në mënyrë vullnetare.	62,886	73,117	100,000	62,347	66,767
	3. Shkalla e mbledhjes së borxheve.	16%	18%	19%		25%

#### Komenti për statusin e arritjeve në aktivitetet 3.1.-3.12

Për vitin 2016, edhe pse në kohë të shkurtër të raportimit, aktivitetet e parapara janë realizuar kënaqshëm nga të dy Agjensionet Tatim Mbledhëse (ATK dhe Doganat). Më saktësisht:

- (3.1) Ministria e Financave është duke shqyrtuar në nivel strategjik Projektligjin e draftuar dhe proceduar për miratim në Qeveri në vitin 2016.
- (3.2) Futja e shërbimit elektronik të e-faturës është paraparë të mbështetet nga sistemi i ri i Teknologjisë Informative pasi që zhvillimi si aplikacion i ndarë nga sistemi nuk do të mund të përkrahte proceset në tërësi.
- (3.3) Faza e prokurimit është përfunduar.
- (3.4) Veprim i realizuar pjesërisht. Gjatë vitit 2017, stafi i Njesisë për Menaxhimin e Rrezikut ka përfituar nga 2 ekspertiza 2 javore nga ekspertët e angazhuar nga FMN.
- (3.5) Gjatë vitit 2017 në total në këto fusha janë trajnuar 105 zyrtar doganor.
- (3.6) Gjatë vitit 2017 janë organizuar 15 aktivitete dhe janë trajnuar 188 zyrtar doganor (në fushat e vlerësimit të mallrave, origjinës, mallrat strategjike, klasifikimin e mallrave, operatorit të autorizuar ekonomik, cilësinë e derivateve etj.).
- (3.7) Përgjatë vitit 2017 janë bërë rifreskime të rregullta të profileve të riskut, bazuar në analizën e riskut, si rrjedhojë janë krijuar 149 profile specifike dhe 3616 subjekte janë proceduar në listat e selektivitetit. Janë realizuar gjithsej 150 patrullime në zonat me rrezikshmëri të lartë.
- (3.8) Gjatë gjithë viti 2017, janë zhvilluar 2,714 patrullime të ndryshme.
- (3.10) Janë zhvilluar aktivitete me policinë kufitare.
- (3.9) Në pjesën e parë të vitit 2017 kamerat janë shfrytëzuar nga drejtoria e zbatimit të ligjit.
- (3.11-3.12) Ka progres në të dy aktivitetet që kanë të bëjnë me Drejtorinë e Zbatimit të Ligjit.

### 3.2.- Progresi i përgjithshëm i zbatimit të reformave në shtyllën 2: Efektiviteti Alokues

Në shtyllën e dytë të SRMFP, Efektiviteti Alokues, janë dhënë 3 Prioritete. Në këtë seksion po e prezantojmë progresin në drejtim të arritjes së objektivit dhe aktiviteteve të ndërlidhura për çdo prioritet në këtë shtyllë.

#### 3.2.1.- Prioriteti 4: Zhvillimi i kornizës afatmesme të shpenzimeve (KASH)

Planifikimi afatmesëm i resurseve publike përmes KASH është një nga fushat prioritare të reformës.

Vlerësimet e vitit 2017 raportojnë për një ndërlidhje të mirë të strategjive kombëtare dhe proceseve buxhetore vjetore përmes avancimit të rolit të KASH si një instrument i planifikimit dhe ndarjes afatmesëm të buxhetit.

Përqindja e shmangies mesatare ndërmjet kufirit të KASH dhe kufirit vjetor buxhetor për OB-të në vitin 2017 ishte 22.03 %. Kjo nuk ndërlidhet domosdoshmërisht me mangësitë në planifikim. Shkaku kryesor i shmangies është për shkak të rritjes së buxhetit në krahasim me KASH.

Në vitin 2017 numri i zyrtarëve të këshilluar për vlerësimin e ndikimit buxhetor (VNB), trajnime dhe këshillime të personalizuara, ka qenë rreth 90. Krahasuar me vitin 2016, në vitin 2017 ishin 10 më shumë.

Qasja sektoriale, komunikimi dhe këshillimi i profesionalizuar nga MF ka ndikuar në fuqizimin e integritet të KASH si dokument bazë për përpilimin buxhetit vjetor dhe vlerësimin për dy vitet e ardhshëm.

Objekti	Indikatori (-ët) për matjen e arritjes së objektivit	Baza	Vlera e synuar 2018	Qëllimi 2020	Raportimi 2016	Raportimi 2017
Avancimi i mëtejshëm i rolit të KASH si dokument ndërlidhës ndërmjet Strategjive Kombëtare dhe planifikimit të buxhetit për tre vitet e ardhshme.	1. Përqindja e shmangies mesatare ndërmjet kufirit të KASH dhe kufirit vjetor buxhetor për OB-të.	7.15 % <sup>6</sup>	6.5 %	3.5%	3.52 % (7.66 %)*	22.03 %
	2. Numri i zyrtarëve të trajnuar për vlerësimin e ndikimit buxhetor-VNB.	80 <sup>7</sup>	90	120	40+40	90

#### Komenti për statusin e arritjeve në aktivitete 4.1.-4.6

Aktivitet dhe arritjet e planifikuara në këtë fushë prioritare janë përmbushur pjesërisht. Më saktësisht:

- (4.1) Grupi Drejtues për Planifikim Strategjik (GDPS) dhe i Komisionit për Planifikim janë funksional.

<sup>6</sup>Vlera bazë i referohet vitit 2015

<sup>7</sup>Vlera bazë i referohet vitit 2015



- (4.2) MF ka ofruar këshillime të nevojshme profesionale për zyrtarë të OB-ve të nivelit qendror.
- (4.3) Tabela e standardizuar për paraqitjen e shmangieve në kufijtë e KASH dhe ndarje buxhetore finale ende është në fazën konceptuale.
- (4.4) Formatet dhe metodat standarde për vlerësim të rrezikut janë definuar bazuar në modelin e COSO. Të gjitha OB kanë përgatitur regjistrat e rreziqeve.
- (4.5) KASH 2018-2020 është përgatitur sipas qasjes sektoriale (12 Sektorë).

### 3.2.2.- Prioriteti 5: Besueshmëria dhe kontrolli i ekzekutimit të buxhetit vjetor

Fuqizimi i besueshmërisë së buxhetit vjetor përmes përmirësimit të planifikimit buxhetor përfshirë planifikimin në nivel të programeve dhe përputhjes me kornizën makro-fiskale si dhe objektivat strategjike të Qeverisë është një prioritet i SRMFP.

Përgjatë vitit 2017, Grupi Koordinues, sipas të dhënave të raportuara, konkludon se ka një trend të qëndrueshëm në fuqizimin e planifikimit buxhetor vjetor dhe konsistencës së ndërlidhjes së buxhetit vjetor me politikat strategjike publike dhe kornizën makro-fiskale.

Për vitin 2017, shmangia mesatare (%) e ekzekutimit të përgjithshëm të buxhetit krahasuar me buxhetin e aprovuar në fillim të vitit sipas OB-ve të nivelit qendror është 11.42 % (EUR 180 milion më shumë Buxhet i Aprovuar). Ky tregues është më lartë se sa viti referues (10.46 %) dhe plani për arritje afatmesme (9%).

Numri i transfereve gjatë vitit 2017, krahasuar me 2016 dhe vitin 2017 është në trend përmirësimi.

Objektivi	Indikatori (-ët) për matjen e arritjes së objektivit	Baza	Vlera e synuar 2018	Qëllimi 2020	Raportimi 2016	Raportimi 2017
Fuqizimi i besueshmërisë së buxhetit vjetor përmes përmirësimit të planifikimit buxhetor dhe besueshmërisë së tij, përfshirë planifikimin në nivel të programeve, për të siguruar që hartimi i buxhetit është në përputhje me kornizën makro-fiskale si dhe objektivat strategjike të Qeverisë.	1. Përqindja e shmangies mesatare të ekzekutimit të përgjithshëm të buxhetit krahasuar me buxhetin e aprovuar në fillim të vitit sipas OB të nivelit qendror.	10.46% <sup>8</sup>	9.0%	5%	3.86%	11.42 %
	2. Nr. i transfereve gjatë vitit fiskal	199 <sup>9</sup>	170	100	188	149

#### Komenti për statusin e arritjeve në aktivitetet 5.1-5.5

- (5.1) Përgatitja e udhëzimit administrativ për transferimet nuk është bërë.
- (5.2) Buxhetimi i bazuar në programe është cak i ndërmjetëm (2018) .
- (5.3) Hartimi i një plani strategjik për buxhetimin Programor është cak i ndërmjetëm (2018).

<sup>8</sup>Vlera bazë i referohet vitit 2015

<sup>9</sup>Vlera bazë i referohet vitit 2015



### 3.2.3.- Prioriteti 6: Cilësia e informatave të buxhetit kapital

Ndërlidhja sistematike e projekteve kapitale me Strategjinë Kombëtarë për Zhvillim dhe me politikat sektoriale, dhe cilësia e analizës teknike të projekteve është një nga objektivat e SRMFP.

Në vitin 2017 ka trend përmirësimi (rënie) në numrin e ri-alokimeve për OB të nivelit qendror. Megjithatë, përqindja e zbatimit të buxhetit të investimeve kapitale krahasuar me buxhetin e planifikuar brenda një viti fiskal është ende sfidë. Ky tregues është 59 %, dukshëm më pak se viti 2016 (86 %) dhe synimi për 2020 (100%). Grupi konsideron se ky tregues duhet rishikuar, sepse ndërton mbi supozim jo real (100%).

MF ka vazhduar me dhënien e trajnimeve të domosdoshme dhe kjo ka ndikuar në rënien e ri-alokimeve për projekte kapitale.

Objektivi	Indikatori (-ët) për matjen e arritjes së objektivit	Baza	Vlera e synuar 2018	Qëllimi 2020	Raportimi 2016	Raportimi 2017
Një menaxhim më efikas dhe më efektiv i planifikimit dhe monitorimit të investimeve publike nga OB-të në sistemin e PIP-it do të ndikoj në një planifikim të drejt të projekteve kapitale që duhet të jenë të ndërlidhura me Strategjinë Kombëtarë për Zhvillim dhe me prioritetet e Qeverisë.	1. Numri i ri-alokimeve për OB të nivelit qendror.	65 <sup>10</sup>	55	25	56	33
	2. Përqindja e zbatimit të buxhetit të investimeve kapitale krahasuar me buxhetin e planifikuar brenda një viti fiskal	98% <sup>11</sup>	99 %	100 %	86 %	59 % <sup>12</sup>

#### Komenti për statusin e arritjeve në aktivitetet 6.1.-6.4

Për arritjen e këtij objektivi janë planifikuar katër aktivitetet. Saktësisht:

- (6.1) Është formuar grupi punues brenda Departamentit të Buxhetit që të hartoj draftin e Projekt Rregullores.
- (6.2) Janë trajnuar 40 Zyrtar për PIP (ishin 120 të planifikuar).
- (6.3) Grupi punues është formuar por ende nuk është bërë draft I parë I udhëzimit.
- (6.4) Staf I ri është punësuar në vitin 2016 (1 Administrator).

### 3.3.- Progresi i përgjithshëm i zbatimit të reformave në shtyllën 3: Efikasiteti operacional

Efikasiteti Operacional është adresuar përmes katër Prioriteteve në SRMFP. Në këtë shtyllë reformat fokusohen në buxhetin kapital, prokurimin, kontrollin e brendshëm dhe auditimin e jashtëm. Në vijim do të prezantojmë arritjet për prioritetet e shtyllës 3.

<sup>10</sup>Vlera bazë i referohet vitit 2015

<sup>11</sup> Vlera bazë i referohet vitit 2015

<sup>12</sup> Mos realizim i shpenzimeve është si pasojë e mjeteve të AKP të paraqitura në BA dhe klauzola e investimeve

### 3.3.1.- Prioriteti 7: Prokurimi Publik

Prokurimi Publik është një ndër hallkat kryesore në garantimin e përdorimit transparent, efikas dhe të drejtë të fondeve publike bazuar në parimin e “vlerës për para”.

Në këtë objektiv të reformës së SRMFP, veprime janë ndërmarr në ngritjen e kapaciteteve teknike, sistemore dhe njerëzore. Të gjitha këto kanë rezultuar me ruajtje të trendit të ngritje të garancive për sigurimin e përdorimit efikas dhe transparent të fondeve publike.

Pjesëmarrja e vlerës së kontratave të nënshkruara gjatë vitit 2017 sipas procedurës së negociuar pa publikim të njoftimit për kontratë është 9.17%. Ky tregues ndikon për trend në drejtim të arritjes së cakut për vitin 2020.

KRPP gjatë vitit 2017 ka monitoruar 70 % të njoftimeve për kontratë dhe kjo është krahasimisht shumë me mirë sesa ishte në vitin 2015 (5%) por më pak se 2016.

Objektivi	Indikatori (-ët) për matjen e arritjes së objektivit	Baza	Vlera e synuar 2018	Qëllimi 2020	Raportimi 2016	Raportimi 2017
Sigurimi i përdorimit efikas, transparent dhe të drejtë të fondeve publike si dhe realizimi i parimit kryesor në prokurimin publik “vlera për para”.	1. Përqindja e përdorimit të Procedurës së Negociuar pa publikim.	12,98 % <sup>13</sup>	10%	7%	11.76 %	9.17%
	2. Përqindja e monitorimit të njoftimeve për kontratë.	5%	100 %	100%	80%	70%

#### Komenti për statusin e arritjeve në aktivitetet 7.1-7.5

- (7.1) Që nga data 01.01.2017 përdorimi i platformës së e-prokurimit është bërë obligativ për të gjitha organizatat buxhetore të nivelit qendror, nivelit lokal dhe ndërmarrjet publike, për procedurat e prokurimit, me vlera të mesme dhe me vlera të mëdha. Operatorët ekonomik janë të obliguar të regjistrohen në sistemin e e-prokurimit dhe të dorëzojnë ofertat në mënyrë elektronike ose në formë fizike.
- (7.2) Në fillim të vitit 2017 është aprovuar nga Qeveria Udhëzuesi Administrativë për Prokurimet e Centralizuara. Gjatë vitit janë kontraktuar furnizime dhe shërbime me prokurim të centralizuar.
- (7.3) KRPP gjatë vitit 2017:
  - o I ka realizuar monitorimin e pesëdhjetë e tri (53) aktiviteteve të prokurimit , sipas rastit – kërkesës, së AK-së, Operatorëve Ekonomik apo palëve të interesuara, prej tyre 3 autoriteteve kontraktuese në 22 aktivitete të prokurimit ju ka bërë edhe monitorimi i menaxhimit të kontratës.
  - o Është bërë monitorimi i rreth 70% të njoftimeve per kontratë para publikimit në ueb faqen e KRPP-së.
- (7.4) KRPP në bashkëpunim me IKAP, ka mbajtur trajnime për përdorimin e sistemit të e-prokurimit për Zyrtaret e prokurimit në nivel qendror, lokal dhe ndërmarrjet publike operatorët ekonomik, OJQ, auditorët e brendshëm të institucioneve publike lokale dhe qendrore, auditorët e jashtëm, hetues, Zyrtaret Kryesor Administrativ, Anëtarët e Komisionit për vlerësim të tenderëve dhe hetues. Gjithsejtë numri i të trajnuarve është 625 persona.

<sup>13</sup>Vlera bazë i referohet vitit 2014. Për vitin 2015 vlera është 16.1%

- (7.5) KRPP në bashkëpunim me IKAP në vitin 2017 ka mbajtur trajnim të nivelit bazik për Zyrtarët e Prokurimit nga të gjitha institucionet publike qendrore, lokale dhe ndërmarrjet publike të cilët nuk posedojnë certifikata për prokurim publik, gjithsejtë u certifikuan 256 pjesëmarrës.

### 3.3.2.- Prioriteti 8: Fuqizimi i auditimit të brendshëm

Veprimet e planifikuara të SRMFP kanë vazhduar në 2017 dhe kanë ngritur fuqizimin e funksionit të auditimit të brendshëm në shërbim të qeverisjes dhe menaxhimit llogaridhënës. Përqindja e auditorëve të brendshëm të certifikuar është në trend të arritjes së caktuar të vendosur për 2020. Në vitin 2017, janë certifikuar 85%, apo rreth 20 % shumë sa ishin në vitin 2016. Në treguesin e përqindjes së implementimit të rekomandimeve nga menaxhmenti ka stagnim. Në vitin 2017 ky tregues është 48.59% (54.7% në 2016) më e ulët se viti bazë referues, 51% Veprimet e planifikuara në ngritjen e kapaciteteve sistemore, procedurale dhe fuqizimit të auditorëve të brendshëm kanë ndikuar në fuqizimin e funksionit të auditimit të brendshëm në sektorin publik, andaj priten rezultate të mira.

Objektivi	Indikatori (-ët) për matjen e arritjes së objektivit	Baza	Vlera e synuar 2018	Qëllim i 2020	Raportimi 2016	Raportimi 2017
Fuqizimi i funksionit të auditimit të brendshëm si shërbim me vlerë të shtuar ndaj menaxhimit llogaridhënës	1. Përqindja e auditorëve të brendshëm të certifikuar	50%	80%	90%	65.33%	85%
	2. Përqindja e implementimit të rekomandimeve nga menaxhmenti.	51%	65 %	65 %	54.7%	48.59%

#### Komenti për statusin e arritjeve në aktivitetet 8.1-8.5

- (8.1) Më 27.10.2017 është aprovuar Projekt Ligji për KBFP nga Qeveria e Republikës së Kosovës.
- (8.2) Është bërë përgatitja e manualit për auditimin e prokurimit publik që do të jetë pjesë e manualit të auditimit të brendshëm
- (8.3) 128 auditorë të brendshëm, nga 150 që punojnë si auditorë të brendshëm në sektorin publik, janë të certifikuar 85% prej tyre. Përveç trajnimit në programin për certifikim auditorët e brendshëm janë trajnuar edhe në fushat: Raportim, fuqizimin e ekipeve të auditimit, teknologjinë informative, prokurimin publik, përgatitjen e planit strategjik dhe vjetor të auditimit, implementimin e rekomandimeve të auditimit.
- (8.4) Me përkrahjen e TAIEX-it janë trajnuar dy auditorë të brendshëm për auditimin e fondeve të BE-së
- (8.5) Raporti Vjetor për funksionimin e sistemit të KBFP-së.

### 3.3.3.- Prioriteti 9: Fuqizimi i auditimit të jashtëm

Fuqizimi dhe zhvillimi i auditimit të jashtëm, bazuar në standardet ndërkombëtare profesionale dhe pavarësinë institucionale, është një nga prioritetet e reformës.

Përgjatë vitit 2017, kanë vazhduar veprimet e duhura për të rritur garancinë për pavarësinë institucionale dhe standardet profesionale. Me hyrjen në fuqi të Ligjit të ri në 2016, janë vënë themelet e pavarësisë funksionale.

Përqindja e rekomandimeve të adresuara nga Komisioni Parlamentar të lëshuara nga Zyra Kombëtare e Auditimit nuk është e disponueshme. Përqindja e rekomandimeve të adresuara të rekomandimeve që janë lëshuar nga Zyra Kombëtare e Auditimit është 26 %.

Objektivi	Indikatori (-ët) për matjen e arritjes së objektivit	Baza	Vlera e synuar 2018	Qëllimi 2020	Raportimi 2016	Raportimi 2017 <sup>14</sup>
Zhvillimi i një institucioni suprem të auditimit që funksionon mirë, i cili kryen auditime në përputhje me standardet e auditimit të sektorit publik të pranuar ndërkombëtarisht.	1. Përqindja e raporteve të auditimit të shqyrtuara nga Komisioni për Mbikëqyrje të Financave Publike.	10% <sup>15</sup>	30%	50 %	14.14%	12,5%
	2. Përqindja e rekomandimeve të adresuara të lëshuara nga Zyra Kombëtare e Auditimit	32%	45%	60%		26 %
	3. Përqindja e rekomandimeve të pa adresuara të lëshuara nga Zyra Kombëtare e Auditimit	37%	25%	20%		38 %

*Komenti për statusin e arritjeve në aktivitetet 9.1-9.4*

- (9.1) Pas miratimit të Ligjit të ri, Auditori i Përgjithshëm ka vazhduar me hartimin e legjislacionit sekondar siç janë: Rregullorja për marrëdhënie pune; Rregullorja për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës; Udhëzimin Administrativ për Zbatimin Detyrave dhe Përgjegjësi të Zyrës Kombëtare të Auditimit dhe Entiteteve të Audituar, Rregullorja për Administrimin e Dokumenteve, Udhëzimin Administrativ për angazhimin e ekspertëve të jashtëm dhe është në proces të miratimit Udhëzimi Administrativ për vlerësimin e rezultateve në punë.
- (9.2) ZKA ka vazhduar bashkëpunimin me Zyrën Kombëtare të Auditimit të Suedisë. Gjatë gjysmës së parë të vitit 2017, ZKA të Suedisë ka bërë një vlerësim të lehtë të ZKA sipas asaj Kornize për të gjitha aktivitetet e që kryen ZKA. Auditori i Përgjithshëm e ka themeluar një grup punues i cili është në proces të hartimit të strategjisë së re.
- (9.3) Udhëzuesi dhe metodologjia e ZKA-së për auditimin e rregullsisë azhurnohen në vijimësi për të qenë në përputhje me standardet ndërkombëtare të auditimit. Nën mbështetjen e projektit të binjakëzimit me Zyrën Kombëtare të Auditimit të Polonisë është filluar rishikimi doracakut.
- (9.4) Udhëzuesi dhe metodologjia e ZKA për auditime të performancës azhurnohet në vijimësi për të qenë në përputhje me standardet ndërkombëtare të auditimit. Nëpërmjet bashkëpunimit me ZKA të Suedisë ka vazhduar mentorimi i auditimeve të performancës dhe janë mbajtur punëtori me tema që kanë të bëjnë me auditime të performancës.
- (9.5) Me përkrahjen e GIZ-it është mbajtur punëtori me Komisionin për Mbikëqyrjen e Financave Publike dhe Komisionin për Buxhet dhe Financa për të diskutuar në lidhje me përmbledhjet e raporteve të auditimit të ZKA për Komisionet e Kuvendit.

<sup>14</sup> Përqindja paraqet rekomandimet e vitit 2015, e të zbatuara në vitin 2016

<sup>15</sup>Vlera bazë i referohet vitit 2015

### 3.4.- Progresi i përgjithshëm i zbatimit të reformave në shtyllën 4: Çështjet e lidhura me MFP

#### 3.4.1.- Prioritet 10: Përmirësimi i sistemeve të TI

Teknologjia informative është një nga dimensionet e rëndësishme të SRMFP. Objektivi i këtij prioriteti është përmirësimi i sistemeve, kualitetit dhe besueshmërisë së informatës, përmes integritit dhe mjaftueshmërisë së infrastrukturës.

Objektivi	Indikatori (-ët) për matjen e arritjes së objektivit	Baza	Vlera e synuar 2018	Qëllimi 2020	Raportimi 2016	Raportimi 2017
Përmirësimi i sistemeve të TI që funksionojnë në Ministrinë e Financave për ta përmirësuar cilësinë e informatave financiare.	1. Numri i sistemeve të Integuara	0	5	7	Përgatitjet në vijim	Duke u bërë përzgjedhja e OE

#### Komenti për statusin e aktiviteteve 10.1-10.3

- (10.1) Departamenti i TI-së në bashkëpunim të ngushtë me Komitetin Teknik të TI-së (KTTI) kanë arritur të avancojnë infrastrukturën e TI-së dhe rrjetës së TI-së si parakusht për integrimin e sistemeve të TI-së. Janë hartuar termat e referencës për integrimin e sistemeve të TI-së dhe është shpallur oferta për përzgjedhjen e operatorit ekonomik. Janë mbyllur ofertat dhe komisioni teknik është në fazën e përzgjedhjes së operatorit ekonomik.

- (10.2) Modernizimi i SIMFK, ngritja e kapaciteteve të teknologjisë informative të Thesarit. Është aktivitet që ka filluar në vitin 2017 e ku përfshihen: ndërlidhja me sistemin e BQK-së, zotimet shumë vjeçare dhe bashkëngjitja e dokumenteve financiare gjatë regjistrimeve të transaksioneve në SIMFK.

- (10.3) Krijimi i një arkivi elektronik për Organizatat Buxhetore ka filluar. Sistemi i arkivës elektronike të cilën e përdor Thesari nuk ka pasur kapacitet që të përfshihen të gjitha OB-të. Andaj Thesari është në përpjekje që të ngrit kapacitetet e softuerit dhe numrit të USER-ëve.

#### 3.4.2.- Prioriteti 11: Transparenca për buxhetin

Një prioritet i reformës është edhe standardizimi i planifikimit dhe raportimit të informatës financiare. Gjatë 2017 ka pasur veprime në drejtim të harmonizimit të strukturës së planifikimit dhe raportimit sipas GFS. Megjithatë, përkundër disa veprimeve në drejtim të adoptimit të GFS 2014 dhe publikimit të serive kohore sipas GFS, në këtë tregues nuk ka progres konkret.

Objektivi	Indikatori (-ët) për matjen e arritjes së objektivit	Baza	Vlera e synuar 2018	Qëllimi 2020	Raportimi 2016	Raportimi 2017
Sigurimi i pajtueshmërisë së informatave për buxhetin Kosovës me FMN standard. GFS 2014.	1. Buxhetimi dhe raportimi sipas tabelës së llogaritjeve që është në pajtim me GFS 2014	Ka filluar publikimi 16	Planifikimi sipas GFS 2014	Standardi GFS 2014 në përdorim	Dokumenti ndërlidhës në mes kodeve ekonomike, GFS 2014 dhe ESA 2010.	Pritet rishikimi i Rregullës financiare për Planin Kontabël të harmonizuar me GFSM dhe IPSAS.

<sup>16</sup>Gjatë këtij viti për herë të dytë janë raportuar në GFS (të hyrat dhe shpenzimet) dhe publikuar në web faqen e MF-së, dhe të dhënat për Qeverinë e Përgjithshme sipas GFS.

### Komenti për statusin e aktiviteteve 11.1-11.3

- (11.1) Nuk ka pasur ndonjë ndryshim/avancim në SIMFK në aspektin e raportimit
- (11.2) Nuk është rishikuar rregulla financiare për kontabilitetin e Qeverisë.
- (11.3) Miratimi i një strukture të re kontabël të harmonizuar me IPSAS dhe GFS dhe inkorporimi në SIMFK nuk ka progres.
- (11.4) Përkthimi i manualit nuk është bërë.
- (11.5) Seritë kohore për vitin 2017 janë publikuar në ueb faqen e Ministrisë së Financës.
- (11.6) Është publikuar informatori për qytetarë për Buxhetin e Kosovës për vitin 2017.

### **3.4.3.- Prioriteti 12: Ngritja e qëndrueshme e kapaciteteve në MFP**

Gjendja në këtë prioritet është pothuajse e njëjtë me vitin 2016.

Objektivi	Indikatori (-ët) për matjen e arritjes së objektivit	Baza	Vlera e synuar 2018	Qëllimi 2020	Raportimi 2016	Raportim i 2017
Arritja e një mënyrë sistematike, e integruar e ngritjes së kapaciteteve të nëpunësve civilë në Menaxhimin e Financave Publike duke e shfrytëzuar ekspertizën vendore, të administratës publike dhe atë të jashtme.	1. Numri i programeve të trajnimit për MFP			X programe nga fusha e MFP	Ngritja e kapaciteteve si më parë	Në pritje të zbatimit të Studimit të fisibilitetit
	2. Numri i zyrtarëve të trajnuar në fushën e MFP			Xx zyrtarë të trajnuar në MFP	Ngritja e kapaciteteve si më parë	Në pritje të zbatimit të Studimit të fisibilitetit

### Komenti për statusin e arritjeve ne aktivitete 12.1-12.4

Janë bërë përpjekje për sigurim të fondeve duke filluar në buxhetin e Kosovës dhe tek donatorët, me qëllim të kryerjes së vlerësimit të nevojave dhe pastaj të Studimit të Fisibilitetit. Këto dy aktivitete do të mundësonin marrjen e vendimit për metodën më të përshtatshme për ngritjen e kapaciteteve të nëpunësve civilë në Menaxhimin e Financave Publike në mënyrë sistematike, të qëndrueshme dhe të integruar. Së fundmi është aplikuar me projekt propozim në fondin SAFE me qëllim të përfitimit të përkrahjes financiare për zbatimin e aktiviteteve të lartpërmendura. Në pritje të përgjigjes.

## **4.- Veprimet Prioritare për vitin e ardhshëm**

Ky seksion prezanton hapat e ardhshëm dhe rreziqet e shoqëruara me veprimet që pritet të ndërmerren.

### **4.1.- Prioriteti 1: Saktësia e parashikimit të indikatorëve makroekonomik dhe të hyrave.**

**Veprimet prioritare në përforcimin e saktësisë së parashikimit të indikatorëve makroekonomik dhe të hyrave do të jenë:**

- Trajnimet në disa faza do të vazhdojnë edhe gjatë vitit 2018.
- Do të punohet në ngritjen e bashkëpunimit me Institucionet Ndërkombëtare Financiare rreth paralajmërimit të hershëm të ndryshimeve në ekonominë botërore që kanë ndikim në parashikimin e të hyrave.

Rreziqet e identifikuar në mos-implementimit e këtyre veprimeve janë të lidhura me mungesën e fondeve dhe vonesat në vendimmarrjen menaxheriale. Janë identifikuar edhe rreziqet si më poshtë:

- Nënvlërësimi i kostove të politikave fiskale nga agjencitë mbledhëse të tatimeve përkatëse mbi të cilat përgatiten parashikimet fiskale dhe rrjedhimisht parashikimet makroekonomike.
- Ndryshimet në ekonominë globale që kanë ndikim në parashikimet e të hyrave.
- Mungesa e alokimit të kohës së nevojshme për trajnime për ngritjen e kualitetit të modelit të parashikimeve makroekonomike.

### **4.2.- Prioriteti 2: Kontrolllet efektive të zotimeve**

**Veprimet prioritare në përforcimin e saktësisë së parashikimit të indikatorëve makroekonomik dhe të hyrave do të jenë:**

- Në vitin 2018 pasi të aprovohet Ligji për KBFP në Kuvend, do të ndërmerren aktivitetet e parapara.
- Në agjendën legjislativë parashihet që të rishikohen rregullat përkatëse.

Rreziqet e identifikuar në mos-implementimit e këtyre veprimeve janë të lidhura me mungesën e fondeve dhe vonesat në vendimmarrjen menaxheriale.

### **4.3.- Prioriteti 3: Mbledhja e qëndrueshme e të hyrave**

**Veprimet prioritare në sigurimin e mbledhjes së qëndrueshme të të hyrave do të jenë:**

- ATK është në proces të zbatimit të Udhëzuesit për trajtimin e mos-deklaruesve. Hapat që do të ndërmerren do të jenë gjenerimi i listave të bizneseve të regjistruara në TVSh e që nuk kanë deklaruar këtë lloj të tatimit, dhe pastaj do të kontaktohen nga Qendra e Thirrjeve. Faza e fundit është tërheqja e certifikatës së TVSh dhe publikimi në ueb faqe.
- Rritja e numrit të vizitave përmbushëse me qëllim të uljes së kreditimit tatimor.
- Aplikimi i ndëshkimeve për mos deklarim.
- Hartimi i një plani operativ me afate kohore të qarta për uljen e nivelit të borxhit;
- Përdorimi më aktiv i Modullit për Menaxhimin e Rasteve të Mbledhjes së Detyrueshme.

Rreziqet e identifikuar në mos-implementimit e këtyre veprimeve janë të lidhura me mungesën e fondeve dhe vonesat në vendimmarrjen menaxheriale.

#### **4.4.- Prioriteti 4: Zhvillimi i kornizës afatmesme të shpenzimeve (KASH)**

##### **Veprimet prioritare në avancimin e rolit të mëtejshëm të KASH do të jenë:**

- Përfundimi / Fillimi me aplikimin e tabelës së standardizuar për paraqitjen e shmangies në mes të kufijve të paraqitura në KASH dhe buxhetit të aprovuar në Qeveri; dhe
- Vazhdimi me trajnimet dhe ngritja e kapaciteteve në fushën e vlerësimit të rrezikut në buxhetim sipas kurrikulës standarde.

Rreziqet e identifikuar në mos-implementimit e këtyre veprimeve janë të lidhura me mungesën e fondeve dhe vonesat në vendimmarrjen menaxheriale.

#### **4.5.- Prioriteti 5: Besueshmëria dhe kontrolli i ekzekutimit të buxhetit vjetor**

##### **Veprimet prioritare në drejtim të rritjes së besueshmërisë dhe kontrollit të ekzekutimit të buxhetit vjetor do të jenë:**

- Formimi i grupit punues në nivel të MF-së i emëruar nga Sekretari i Përgjithshëm i MF-së duke përfshirë aktet relevant.
- Analiza dhe memo e mundësive për hartimin e një plani strategjik për buxhetimin programor.

Rreziqet e identifikuar në mos-implementimit e këtij veprimi janë të lidhura me vonesat në vendimmarrjen menaxheriale

#### **4.6.- Prioriteti 6: Cilësia e informatave të buxhetit kapital**

##### **Veprimet prioritare në prioritetin për ngritjen e cilësisë së informatave të buxhetit kapital do të jenë:**

- Formimi i grupit punues në nivel të MF-së i emëruar nga Sekretari i Përgjithshëm i MF-së duke përfshirë aktet relevant.
- Analiza e nevojave dhe ndryshimet e kërkuara në rregullativë për planifikimin, hartimin dhe prezantimin e investimeve kapitale

Rreziqet e identifikuar në mos-implementimit e këtij veprimi janë të lidhura me vonesat në vendimmarrjen menaxheriale

#### **4.7.- Prioriteti 7: Prokurimi Publik**

##### **Veprimet prioritare në prioritetin për ngritjen e cilësisë së informatave të buxhetit kapital do të jenë:**

- Departamenti i monitorimit i KRPP-së do të vazhdojë me monitorime të mëtutjeshme të aktiviteteve të prokurimit.
- KRPP në bashkëpunim me IKAP dhe Donatorët e jashtëm do të vazhdojë të mbajë trajnime për të gjitha palët e interesuara.
- KRPP do të vazhdon mbajtjen e trajnimeve për nivelin bazik për zyrtarët e prokurimit.

Rreziqet e identifikuar në mos-implementimit e këtij veprimi janë të lidhura me vonesat në vendimmarrjen menaxheriale



#### **4.8.- Prioriteti 8: Fuqizimi i auditimit të brendshëm**

##### **Veprimet prioritare në avancimin e rolit të mëtejshëm të KBFP do të jenë:**

- Shqyrtimi i dytë i Projekt Ligjit për KBFP nga Kuvendi i Republikës së Kosovës është bërë më 30.03.2018 dhe tani pritet dekretimi i tij nga Presidenti.
- Aprovimi i manualit për auditimin e prokurimit publik
- Monitorimi i implementimit të rekomandimeve të auditimit të brendshëm.
- Organizimi i 2 punëtorive për trajtimin e procesit të implementimit të rekomandimeve
- Sensibilizimi i OB-ve dhe Komitetet e auditimit që në mënyrë sistematike të bëjnë përcjelljen e implementimit të rekomandimeve

Rreziqet e identifikuara në mos-implementimit e këtyre veprimeve janë të lidhura me:

- Vonesa në dekretimin e Ligjit të KBFP,
- Vonesa e përfundimit dhe aprovimit të manualit për auditimin e prokurimit publik,
- Mos zbatimi i rekomandimeve të auditimit nga Menaxhmeti,
- Pjesëmarrje jo adekuate e personave kompetent në punëtoritë ku trajtohet çështja e implementimit të rekomandimeve të auditorit,
- Të kuptuarit e rolit të auditimit nga menaxhmeti, anëtarët e komiteteve të auditimit dhe mos pagesa e Komiteteve të Auditimit.

#### **4.9.- Prioriteti 9: Fuqizimi i auditimit të jashtëm**

##### **Veprimet prioritare në zhvillimin e mëtejshëm të ZKA-s do të jenë:**

- Adresimi në çështjet e identifikuara në Raportin e Vlerësimit bazuar në Kornizën e Matjes së Performancës së Institucioneve Supreme të Auditimit të kryer nga Zyra Kombëtare e - Auditimit të Suedisë dhe do të përfundojë së hartuari Strategjia e re e ZKA-së.
- Organizimi i programeve të trajnimit për implementimin e manualit të auditimeve të pajtueshmërisë. Do të plotësohet udhëzuesi i rregullsisë me pjesën për auditime të ndërmarrjeve publike.
- Dizajnimi dhe implementimi i skemës së certifikimit me përkrahjen e Zyrës Kombëtare të Auditimit të Suedisë dhe partnerëve tjerë.
- Komunikimi me Komisionet e Kuvendit me qëllim të koordinimit më të mirë për trajtimin e Raporteve të Auditimit.
- Komunikim të vazhdueshëm dhe përkrahjes së Komisioneve të Kuvendit për rritjen e numrit e trajtimeve të Raporteve të auditimit në Kuvend dhe rritjen e shkallës së rekomandimeve të adresuara përkatësisht zvogëlimin e shkallës së rekomandimeve të pa adresuara.

Rreziqet e identifikuara në mos-implementimit e këtyre veprimeve janë kufizimet e kapaciteteve njerëzore dhe bashkëpunimi ndërmjet njësive/ institucioneve.

#### **4.10.- Prioritet 10: Përmirësimi i sistemeve të TI**

Hapat e ardhshëm për vitin 2018 janë:

- Përzgjedhja e operatorit ekonomik dhe fillimi i zbatimit të projektit. Rezultatet e para priten në fund të vitit 2018.
- Ndërlidhja me sistemin e BQK-se, zotimet shumë vjeçare, bashkëngjitja e dokumenteve financiare gjate regjistrimeve të transaksioneve në SIMFK.
- Ngritja e kapaciteteve të softuerit dhe numrit të USER-ëve.

Rreziqet e identifikuara në mos-implementimit e këtyre veprimeve janë të lidhura me kufizimet financiare dhe në kapacitetet njerëzore.

#### **4.11.- Prioriteti 11: Transparenca për buxhetin**

**Veprimet prioritare në sigurimin e pajtueshmërisë së informatave për buxhetin e Kosovës me FMN / standardin 2014 GFS do të jenë:**

- Rishikimi i rregullës financiare për kontabilitetin e Qeverisë. Me rishikimin e rregullës financiare për planin kontabël do të analizohet dhe krijohet mundësia që procesi i buxhetimit, ekzekutimit dhe raportimit të bëhet sipas planit kontabël të harmonizuar me GFSM dhe IPSAS.
- Hartimi i diagramit të llogarive kontabël i harmonizuar me GFSM 2014 dhe IPSAS.

Rreziqet e identifikuara në mos-implementimit e këtyre veprimeve janë të lidhura me mungesën fondeve dhe vonesat në vendimmarrjen menaxheriale.

#### **4.12.- Prioriteti 12: Ngritja e qëndrueshme e kapaciteteve në MFP**

**Veprimet prioritare në ngritjen e qëndrueshme të kapaciteteve në MFP do të jenë:**

- Zhvillimi i Studimit të fizibilitetit, i cili do të hap rrugën për marrjen e vendimit për opsion më të përshtatshëm për ngritjen e qëndrueshme të kapaciteteve në fushën e MFP.
- Bazuar në studimin e fisibilitetit dhe vendimin e marrë, do të zhvillohet Kurrikula.
- Zhvillimi i Moduleve të Trajnimit, dhe
- Trajnimi i Trajnerëve.

Rreziqet e identifikuara në mos-implementimit e këtyre veprimeve janë të lidhura me;

- sigurimin e mjeteve për Studimin e fisibilitetit dhe
- Vendim marrja me kohë për opsionin e rekomanduar nga studimi.